




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 7 nëntor 2025
Kodi i ZRRE-së: V_2937_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenin 25, Nenit 26 dhe nenin 42 paragrafi 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Nenit 8 paragrafët 1, 2, 4, 8 dhe 11 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Dispozitat e Rregullës Nr. 03/2020 dhe Metodologjisë për Përgatitjen e Balanceve të Energjisë;
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) për shqyrtim dhe aprovim të Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike për vitin 2025,

në seancën e mbajtur me datë 7 nëntor 2025, nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** - Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike për vitin 2025.
- II. Zyra e Rregullatorit për Energji do të monitoroj implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë elektrike si në dispozitivin nën pikën I. të këtij Vendimi, për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në Bilanc.

A r s y e t i m

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme ZRRE) me datë 11.10.2024 ka pranuar nga operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (në tekstin e mëtejme KOSTT Sh.A.), kërkesën për aprovim të Bilancit Vjetor i Energjisë Elektrike 2025.
- o Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike paraqet planin vjetor të shpenzimit të energjisë elektrike në raport me energjinë elektrike në dispozicion. Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike bazohet në nevojat e planifikuara të konsumit të energjisë elektrike për vitin 2025, i cili është parashikuar të furnizohet nga gjenerimi vendor dhe importi i energjisë elektrike. Po ashtu në bilanc parashikohet edhe eksportimi i tepricave të energjisë elektrike.
- o Qëllimi kryesor i Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike është që të projektojë përmbushjen e nevojave të konsumatorëve me energji elektrike, në sasi të mjaftueshme gjatë vitit, duke



- angazhuar kapacitetet e prodhimit dhe transmetimit në mënyrën sa më të mirë tekniko-ekonomike.
- Ministria e Ekonomisë ka paraqitur mendimin Nr. prot. 5792 të datës 30.09.2024 për draft dokumentin, ku kanë paraqitur komentet dhe propozimet e tyre në dokumentin përkatës, të cilat i kanë dorëzuar në KOSTT SH.A.
- Bordi i ZRRE-së, pas shqyrtimit të Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike 2025 ka kërkuar që të bëhen ndryshime të caktuara.
- ZRRE konsideron se janë përmbushur kriteret për aprovim, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

- **Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2025**

Bordi i ZRRE-së,

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtar

Gani Buçaj, anëtar

Arta Isufi, anëtar

Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi i dërgohet:

- KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji